



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Kërkimi Shkencor në Mësimdhënien e Gjuhës B

Ngarkesa: 6 kredite; 60 orë mësimore; 30 leksione / 30 seminare

Viti / Semestri : Viti II, semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master i Shkencave në Mësuesi 'Gjuhë e Huaj, Gjuhë Italiane'.

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Të pajisë studentët me një kuadër të plotë teorik dhe praktik mbi metodologjinë e kërkimit shkencor në fushën e didaktikës së gjuhës italiane. Të zhvillojë tek studentët aftësinë për të konceptuar dhe realizuar një projekt kërkimor në mënyrë të pavarur dhe bashkëpunuese. Të nxisë formimin e një mendësie kërkimore në fushën e mësimdhënies, me synim zhvillimin profesional dhe angazhimin në mësimdhënien gjatë gjithë jetës.

Objektiva specifike lëndore:

1. Të aftësohen studentët në ndërtimin e projekteve kërkimore përmes përzgjedhjes së temës, hartimit të hipotezave dhe strukturimit të metodologjisë.
2. Të ushtrohen në mbledhjen, analizimin dhe interpretimin e të dhënave sasiore dhe cilësore në funksion të kërkimit shkencor.
3. Të njohin dhe aplikojnë praktikat akademike të raportimit shkencor, përfshirë analizën kritike të literaturës dhe referencimin bibliografik.

Rezultatet e pritshme:

1. Studentët do të jenë në gjendje të ndërtojnë dhe zbatojnë një projekt kërkimor në fushën e didaktikës së gjuhës italiane, duke ndjekur kriteret metodologjike dhe etike.
2. Studentët do të zhvillojnë kompetenca për të analizuar në mënyrë kritike literaturën dhe rastet studimore, si dhe të nxjerrin përfundime të mbështetura në të dhëna konkrete.
3. Studentët do të jenë në gjendje të prezantojnë rezultatet e punës së tyre kërkimore në mënyrë të argumentuar dhe koherente, në përputhje me standardet akademike.